

VENDIM
Nr. 841, datë 28.10.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 634, DATË 25.9.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM DHE VENDOSJEN E SERVITUTIT MBI PASURITË E PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA PUNIMET PËR TESTIMIN ME UJË TË TUBACIONIT DHE PËRFUNDIMI I PUNIMEVE, PJESË E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIC PIPELINE (PROJEKTI TAP), NË ZONAT BERAT, SKRAPAR, FIER, LUSHNJË, DEVOLL DHE KORÇË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 7 e 8, pjesa e parë dhe e dytë, të shtojcës 1, të marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr.116/2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG", si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.634, datë 25.9.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Pikat 3, 5 dhe 6, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, të paraqitur në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 35 781 946.06 (tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë pikë zero gjashtë) lekë, për sipërfaqet:

 - 10 289 (dhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) m² që shpronësohet;
 - 471 765.35 (katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e pesë) m², që merret në përdorim të përkohshëm;
 - 1 978 (një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) m² mbi të cilën vendoset servituti.
 5. Vlera e përgjithshme, prej 35 781 946.06 (tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë pikë zero gjashtë) lekësh, të përballohet nga shoqëria TAP AG, si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.
 6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 16 464 300 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind) lekë, të përballohen nga shoqëria TAP AG."
 - b) Të dhënat për numrin rendor 339, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria TAP AG, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përkatësisht: Berat, Skrapar, Fier, Lushnjë, Devoll dhe Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA PUNIMET PËR TESTIMIN E TUBACIONIT ME UJË, SI DHE PËRFUNDIMI I PUNIMEVE, QË MERREN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR PERIUDHËN 6 (GJASHTË) MUJORE, 1 (NJË) VJEÇARE, 1 (NJË) VIT E 6 (GJASHTË) MUAJ DHE 2 (DY) VJEÇARE, SI EDHE E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN DHE MBI TË CILAT VENDOSET SERVITUTI RRETHET: KORÇË, DEVOLL, SKRAPAR, BERAT, FIER DHE LUSHNJË

Nr., në VKM nr.634 dt.25.09.201 9	Pronari			ZK.	Nr.Pas.	Lloji Pas.	Sip. m2 për Marrje në Përdorim të Përkohshëm	Vlera Lekë	Sip. m2 Servitut	Vlera Lekë	Sip. m2 Shpronësim	Vlera Lekë	Vlera Totale e Kulturave	Vlera Totale Lekë	Indexi Hartës	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri													
	PASURITË QË MERREN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR 6 (GJASHTË) MUAJ															
339	Gazmon	Qemal	Bajraktari	1355	119/19	Arë	1,240	200,260	270	87210				287,470	K-34-114-237-B	E konfirmuar nga ZVRPP pajisur me Certifikatë Pronësie
	Namik	Qemal	Bajraktari													